



|  |            |
|--|------------|
| REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLICA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO                          |            |
| AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT<br>AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE<br>ANTI-CORRUPTION AGENCY |            |
| Dep.   | 2-D / DPK  |
| Dep.   | 01-3394/15 |
| Dep.   | 02         |
| Nr. Ifaq.  |            |
| Broj stranica  |            |
| Nr. pages  |            |
| Data   | 19.10.2015 |
| Datum  |            |
| Prot No.   |            |



## Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosova

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT  
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE  
ANTI – CORRUPTION AGENCY**

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 24 paragrafi 11 dhe 12 të Rregullorës së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 14.10.2015, nxjerr këtë:

### V E N D I M

**I. Mbylljet rasti me Nr. AKK-03-02-2517-15 për z.Fatmir Gashi – Zavendës Guvernator për funksione të përgjithshme në Bankën Qendrore të Kosovës (BQK), për shkak se është shmangur situata e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, meqë z.Gashi ka heq dorë nga funksioni i personit të autorizuar në një biznes privat, duke shmangur konfliktin e interesit në ushtrimin e funksionit të tij publik.**

**II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.**

### A r s y e t i m

**I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt interesit në ushtrimin e funksionit publik, me nr. AKK-03-02-2517-15, për Zyrtarin e lartë, z.Fatmir Gashi– Zavendës Guvernator për funksione të përgjithshme në Bankën Qendrore të Kosovës (BQK), dhe njëkohësisht person i autorizuar në biznesin privat, është trajtuar sipas procedurës së paraparë ligjore, për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik (Ligi Nr. 04/L-051).**

Zyrtari i lartë, z.Gashi është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit, pas të cilës ai është kontaktuar nga zyrtarët e Agjencisë kundër Korrupsionit, me ç'rast është njoftuar me situatën në të cilën ndodhet, si dhe me ndryshimet që duhet të bëjë, për të shmangur situatën e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit të tij publik.

Zyrtari i lartë, z.Gashi, është deklaruar se brenda afatit të dhënë ligjor, do t'i bëjë ndryshimet e kërkua të Agjencionin për regjistrimin e Bizneseve të Kosovës.

Ndërkohë, ai, në Agjencinë kundër Korrupsionit, ka sjell një shkresë përcjellëse (përgjigje) si dhe shkresën zyrtare nga Agjensioni për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (ARBK) "Informata mbi biznesin"(DPK/DPKI-03-02-3252/15), në të cilën shihet se z.Gashi tashmë ka heq dorë nga ushtrimi i funksionit të personit të autorizuar në biznesin; Shoqëri me përgjegjësi të

kufizuar, "Kosovo Terrestrial Telecommunication Network – KTTH L.L.C." , me çka ka shmangur konfliktin e interesit në ushtrimin e funksionit të tij publik.

II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK-së
- Z./zpj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./zpj. (zyrtari ndihmës)

